



Planuar / Doretuar Punijeno / Prodato Received / Delivery	03 - 03 2023	3 viti god year	
Organ / Njesia Org. / Jedinica Org. / Unit	Nr Prot Bt Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SPANSHCK	2340 / 2023		115



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.644/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, jeton Koca dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.2168/21 të datës 26.01.2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.644/2021 të datës 15.07.2021 të parashtruar nga ankuesi

në çështjen juridike "kundërshtim i masës disiplinore", duke vepruar sipas nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, nenit 16 paragrafi 3 dhe nenit 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 03.03.2022, njëzëri mori këtë:

### V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.644/2021 e datës 15.07.2021, e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi masa disiplinore "Vërejte" e shqiptuar ndaj ankuesit, më datë 06.07.2021 nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migracion në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

### A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme, më datë 15.07.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 3730/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër masës disiplinore "Vërejte" të shqiptuar më datë 06.07.2021 nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migracion pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të Ligjit për Zyrtarët Publikë dhe Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës (me tej Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në

Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 21.07.2021 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit të Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa Këshilli më datë 02.08.2021 ka pranuar shkresat lidhur me çështjen në procedurë të vendosjes.

Këshilli në mungesë të kuorumit për vendosje nuk ka shqyrtuar ankesën e ankueses, me c' rast përmes shkresës me numër protokolli .4437/2021 të datës 30.08.2021 ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës, duke e udhëzuar të njëjtin lidhur me të drejtën për inicim të konfliktit administrativ në gjykatën kompetente.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me Aktgjykimin A.nr.2168/21 të datës 26.01.2023, ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit në këtë rast ankuesit dhe ka detyruar Këshillin që brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh të vendos për ankesën e ankuesit A.nr.644/2021 të datës 15.07.2021.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokolli 3730/2021 të datës 15.07.2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin e datës 06.07.2021 për shqiptimin e masës disiplinore "vërejtje"; Kërkesën përmes e-mailit të datës 30.06.2021 nga L.N për ankuesin; Kërkesën për prioritet e datës 07.05.2021 nga ankuesi për L.E; Kërkesën me prioritet përmes e-mailit e datës 07.05.2021 nga L.N; E-mailin e datës 06.05.2021 nga ankuesi për Nj.K; E-mailin e datës 29.06.2021 nga I.S; Kërkesën për përdorimin e automjeteve zyrtare pas orarit të rregullt të punës për Qendrën për Azil dhe Qendrën për Mbjajtjen e të Huajve e datës 18.11.2020; E-mailin e datës 19.05.2021 nga ankuesi; Raporti për muajin maj 2021 i datës 01.06.2021 nga ankuesi; E-mailin e datës 07.04.2021 nga ankuesi; E-mailin e datës 30.12.2020 nga ankuesi; Fotografitë e dërguara nga ankuesi; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 16.02.2021 për ankuesin; Ndryshimin dhe Plotësimin e Aktit të Emërimit i datës 14.12.2008 i ankuesit; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Udhëheqës i Qendrës për Mbjajtjen e të Huajve; Vendimin e datës 05.05.2021 të Sekretarit të Përgjithshëm të MPB për caktimin e Zëvendësuesit të Drejtorit të Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migracion; Kërkesën për miratimin e udhëtimit zyrtar të datës 28.06.2021; Kërkesën për udhëtim zyrtar të datës 28.06.2021; Draft Agjenda; Autorizim i datës 02.07.2021; E-mailin e datës 27.05.2021 nga ankuesi; E-mailin e 27.05.2021 dhe 25.05.2021 nga Gani Kastrati për te tjerët; E-mailin e datës 26.05.2021 nga ankuesi; E-mailin e datës 25.05.2021 nga Fitim Tahiri; E-mailin 25.05.2021 nga V.G; E-mailin e datës 02.06.2021 nga H.H; E-mailin e datës 02.06.2021 nga ankuesi; E-mailin e datës 01.06.2021 nga I.H; Raportin e oficerit-olicisë të datës 26.05.2021, 03.06.2021 dhe 16.02.2021; E-mailin e datës 19.05.2021 nga ankuesi; E-mailin e datës 19.05.2021 nga L.N për ankuesin; E-mailin e datës 11.06.2021 nga ankuesi; E-mailin e datës 11.06.2021 dhe 10.06.2021 nga V.G; E-mailin e datës 18.05.2021 nga ankuesi; E-mailin e datës 17.05.2021 nga V.G për ankuesin; E-mailin e datës 17.05.2021 nga A.D; E-mailin e datës 16.05.2021, 25.05.2021 nga ankuesi; Raporti i Policisë i datës 02.06.2021 dhe 09.06.2021; Raporti i Auditimit të Brendshëm për Qendrën për Mbjajtjen e të Huajve të datës 14.05.2021; Përgjigjen në ankesë e datë 02.08.2021 dhe Kërkesën për përgjigjen në ankesë e datës 21.07.2021; Njoftimin e datës 30.08.2021 dhe Aktgjykimin A.nr.2168/21 të datës 26.01.2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar që ankesa e ankuesit është e pabazuar, sepse:

Nga administrimi i provave materiale rrjedhë së ankuesi është i punësuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme, gjegjësisht i njëjti sipas aktit të emërimit të datës 14.12.2018, është i emëruar dhe ushtron pozitën "Udhëheqës i Qendrës për Mbajtjen e të Huajve".

Me tej nga shkresat e lëndës rezulton së Zëvendësuesi i Drejtorit të Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migracion, në cilësi të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të ankuesit, më datë 06.07.2021, përmes emailit zyrtar ka shqiptuar ndaj ankuesit masën disiplinore "vërejtje", me pretenimet se ankuesi në vazhdimësi kishte treguar mosbashkëpunim, komunikim degradues dhe të papranueshëm në raport me udhëheqësin e tij, me zyrtarët brenda institucionit si dhe akterët tjerë bashkëpunues si dhe ankuesi në vazhdimësi ka anashkaluar dhe nuk ka respektuar hierarkinë më rastin e komunikimit.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se me rastin e shqiptimit të masës disiplinore "Vërejtje" të datës 06.07.2021 nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migracion ka pasur shkelje procedurale të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë dhe Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Lidhur me shqyrtimin e themelësisë së pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit i'u referua dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht:

Nenit 45 më të cilin është përcaktuar se: "Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit".

Nenit 46 më të cilin janë trajtuar shkeljet disiplinore ku shprehimisht thuhet se: shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore. 2. Shkeljet disiplinore ndahen në: 2.1. shkelje të rënda; 2.2. shkelje të lehta, ...4 Shkelje të lehta konsiderohen: 4.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune; 4.2. shkelja e rregullave të etikës; 4.3. sjellja e parregullt, gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, kolegët, vartësit dhe me publikun; 4.4. kryerja e veprimeve, që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi, brenda ose jashtë orarit zyrtar".

Nenit 47 paragrafi 1 me të cilin është përcaktuar se: "Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil".

Nenit 48 paragrafi 1 ka përcaktuar se: "1. Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë....".

Nenit 50 paragrafi 3 dhe 4 ku thuhet se: *"3. Për shkeljet e rënda, jepen masat disiplinore të përcaktuara në paragrafët 1.2 deri 1.4 të nenit 47 të këtij ligji. 4. Për shkeljet e lehta, jepen masat disiplinore të përcaktuara në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji.*

Rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore, Kolegji ka analizuar provat ndërlidhur me këtë çështje juridiko-administrative si dhe shkresën për shqiptimin e masës së goditur më ankesë, dhe si rrjedhojë ka konstatuar se Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankuesit ka shqiptuar ndaj të njëjtit masën disiplinore "vërejtje", mbi bazën së ankuesi në vazhdimësi ka treguar mos bashkëpunim, komunikim degradues dhe të papranueshëm në raport me udhëheqësin e tij, me zyrtarët brenda institucionit si dhe akterët tjerë bashkëpunues, ndërsa nga vlerësimi i shkresave të lëndës Kolegji ka vlerësuar së udhëheqësi i ankuesit disa herë kishte kundërshtuar formën dhe mënyrën e komunikimit të ankuesit në raport me zyrtarët e MPB-së dhe institucioneve tjera, ndërlidhur me këtë dhe duke i'u referuar emalit të datës 30.06.2021, Kolegji ka gjetur së mbikëqyrësi i drejtpërdrejt ka kërkuar nga ankuesi që zyrtari i pranuar deri në momentin që të vendoset për veturë për këtë zyrtar, udhëtimi vajtje-ardhje të bëhet i përbashkët, ndërsa ankuesi në përgjigje të kësaj kërkesë ishte shprehur se *...unë shofer nuk jam i pranuar në MPB ke kujdes"*, rrjedhimisht, në vlerësimin e Kolegjit ky veprim i ankuesit mund të cilësohet edhe mos zbatim i kërkesave dhe urdhëresave të punës të përcjella nga udhëheqësi dhe si i tillë bie ndesh me nenin 26 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se: *Zyrtari publik ka detyrimin të veprojë në përputhje me urdhrat e marrë nga mbikëqyrësit e tij, sipas ligjit dhe rregullave të brendshme të institucionit"*.

Po ashtu nga shqyrtimi i provat e lëndës, Kolegji i Këshillit ka vlerësuar së ankuesi kishte treguar komunikim jo të përshtatshëm zyrtar në raport edhe me zyrtarët e Policisë së Kosovës dhe IOM-it si partner mbështetës të Ministrisë së Punëve të Brendshme respektivisht të Qendrës për Mbajtjen e të Huajve. Ndërlidhur me këtë konstatim Këshilli i'u referua emalit të datës 27.05.2021 nga ankuesi për Auditorin e Brendshëm të MPB-së, si dhe emalit të datës 03.06.2021 nga ankuesi për zyrtarin policor me inicialet Rr. S, kështu që mbi këtë bazë të konstatimeve Kolegji i Këshillit vlerëson se sjelljet e ankuesit në kuptim të komunikimit jo të rregullt dhe të përshtatshëm me mbikëqyrësin si dhe zyrtarët tjera jashtë institucionit cilësohen si shkelje të lehta disiplinore sipas nenit 46 paragrafi 4 nën paragrafi 4.3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se: *"Shkelje të lehta konsiderohen:... 4.3. sjellja e parregullt, gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, kolegët, vartësit dhe me publikun..."*


Andaj, bazuar në të gjeturat dhe konstatimet si me sipër, Kolegji vlerëson së pretendimet e ankuesit se gjatë shqiptimit të masës disiplinore ka pasuar shkelje procedurale të dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë dhe Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, janë të pabazuara.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit, Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.644/2021

**Avdyll BEKTESHI**  
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Ardita Haxhnikaj-DEMI**  
Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dërgohet**

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.